



U NËNSHKRUA PLANI I PUNËS ME THESARIN E SHBA-SË PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE, LUFTIMIT TË EKONOMISË GRI DHE KORRUPSIONIT

Drejtorët e Drejtorisë së të ardhurave publike, drejtoresha Sanja Lukarevska, e Drejtorisë së doganave, drejtori Stefan Bogoev dhe drejtoresha për politikë dhe administrim të të hyrave në Thesarin e SHBA-së, Parvina Shamsieva Cohen, sot, në prani të ministrit të Financave, Fatmir Besimi, nënshkruan **Planin e punës të projektit për forcimin e kapaciteteve në Drejtorinë e të ardhurave publike dhe Drejtorinë e doganave për vitin 2023-2024**. Në kuadër të projektit, të dy institucionet po krijojnë bashkëpunim me Zyrën e Asistencës Teknike në Thesarin e SHBA-së, e cila do të ofrojë asistencë eksperte për forcimin e kapaciteteve, si dhe mbështetje në përpjekjet për reforma dhe modernizim të ndërmarra në kuadër të **Drejtorisë së të ardhurave publike dhe Drejtorisë së doganave**. Drejtoresha e DAP-it, Sanja Lukarevska, tha se me përmbylljen e këtij plani 18-mujor të punës, Drejtoria e të ardhurave publike do të marrë mbështetje teknike dhe trajnim të punonjësve për: forcimin e kapaciteteve të inspektoratit, menaxhimin e borxhit, përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, menaxhimin e projekteve, auditimin e brendshëm, si dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore si një nga burimet më efikase të institucionit për të ofruar shërbime të shpejta dhe efikase ndaj taksapaguesve.

“Ky bashkëpunim është i një rëndësie vendimtare për ne dhe vjen në një kohë kur ne po zbatojmë procesin e Reformës dhe po ndërtojmë një administratë tatimore moderne, të dixhitalizuar që ndjek trendet botërore dhe mund t'u përgjigjet atyre. Me mbështetjen tuaj dhe iniciativat multifunktionale do të sigurojmë stabilitet dhe siguri dhe do të ndihmojmë në forcimin e mekanizmave kontrollues që mbrojnë interesat e qytetarëve dhe bizneseve, që nga ana tjetër nënkupton edhe përfitime për pjesën e të hyrave të Buxhetit”, *tha Lukarevska*.

Aktivitetet e përcaktuara në këtë plan pune do të rrisin aftësinë e shtetit për të gjeneruar të ardhura më të larta dhe më të besueshme, të cilat do të rrisin aftësinë e qeverisë për të ofruar të mira publike që do të mbështesin rritjen e ekonomisë.

Drejtori Bogoev tha se përmes këtij projekti do të vihen në dispozicion më shumë mjete në buxhet.

Duke lehtësuar tregtinë, fluksi i pandërprerë i mallrave, rritja e dixhitalizimit të proceseve, do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve për kryerjen e biznesit, kryerjen e kontrolleve efikase dhe analizimin e rreziqeve që do të kontribuojnë ndjeshëm në uljen e ekonomisë gri. Në fund të fundit, aktivitetet që përcaktuam me OTA duhet të kontribuojnë në frenimin e korrupsionit, gjë që do të mundësohet duke zbuluar mekanizma për kontroll më të madh. Këto janë një nga aspektet kryesore për zhvillimin e shtetit dhe ne do të punojmë me përkushtim për të arritur qëllimet që i kemi vendosur me këtë plan të punës”, *tha Bogoev*.



Drejtoresha e Politikës dhe Administrimit të të Ardhurave në Thesarin e SHBA-së, Parvina Shamsieva Cohen, vuri në dukje se Zyra e Asistencës Teknike e Thesarit të SHBA-së ndihmon vendet partnere të orientuara drejt reformave për të forcuar menaxhimin e financave publike.

“Ne jemi të lumtur të mbështesim përpjekjet e Ministrisë së Financave për përmirësimin e administratës tatimore dhe doganore në Maqedoninë e Veriut. Plani i punës i nënshkruar sot pasqyron mbështetje të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve nga OTA të Drejtorisë së doganave dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike në përputhje me prioritetet kryesore kombëtare, duke përfshirë reduktimin e ekonomisë në hije, rritjen e pajtueshmërisë vullnetare të taksapaguesve, mobilizimin e burimeve vendase dhe luftën kundër korrupsionit”, tha Cohen.

Ministri i Financave, Besimi sqaroi se në vazhdimësi po punohet për zbatimin e reformës në menaxhimin e financave publike dhe plani i punës i nënshkruar sot do të kontribuojë në forcimin e financave publike, luftën kundër korrupsionit dhe ekonomisë gri.

“SHBA është partneri ynë strategjik dhe kjo nismë e forcon edhe më shumë partneritetin tonë”. Thesari i SHBA-së ofron asistencë teknike të rëndësishme për vendin në forcimin e menaxhimit të financave publike, efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së financave publike, si dhe në trajtimin e ekonomisë në hije. Në këtë mënyrë do të forcojmë kapacitetet e institucioneve tona dhe qëllimi përfundimtar është prosperiteti ekonomik”, *tha ministri i Financave Fatmir Besimi.*

Paralelisht, siç tha ai, po zbatohen procese për prezantimin e platformave të reja moderne dixhitale, si Sistemi i Integruar Informativ për Menaxhimin Financiar në Ministrinë e Financave – SIIMFM, Sistemi i Integruar Informativ Tatimor (SIIT) dhe Sistemi Informativ për Menaxhimin e Ndihmës Shtetërore – SIMNSH.

